

V E N D I M
Nr.212, datë 4.5.1993

PËR METROLOGJINË

Në zbatim të ligjit nr.7625, datë 20.10.1992 "Për njësitë e matjes dhe kontrollin e mjeteve matëse (metrologjinë)", Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Drejtoria Kombëtare e Metrologjisë dhe e Kalibrimit ka në përbërje të saj edhe laboratorët e ruajtjes së etaloneve kombëtare të kontrollit e të kalibrimit të mjeteve matëse, kurse degët e saj në rrethe kanë në përbërje të tyre edhe laboratorët e kontrollit të kalibrimit të mjeteve matëse.

2. Organet e pushtetit lokal në rrethe të marrin masa për përmirësimin dhe plotësimin me mjedise e kushte të përshtatshme pune të degëve të kontrollit e të kalibrimit të mjeteve matëse në rrethe.

3. Organet doganore kryejnë zhdoganimin ose doganimin e mjeteve matëse dhe të lodrave mekanike, elektromekanike ose elektronike me fitim, pas miratimit të marrë nga Drejtoria Kombëtare e Metrologjisë dhe e Kalibrimit.

Drejtoria Kombëtare e Metrologjisë dhe e Kalibrimit, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë, të nxjerrin udhëzimin përkatës.

4. Numri i punonjësve në organikë i Drejtorisë Kombëtare të Metrologjisë dhe të Kalibrimit të jetë 90 punonjës, prej të cilëve 27 punonjës merren duke pakësuar 1 punonjës nga organika e këshillave të rretheve dhe Bashkisë së Tiranës, me përjashtim të rretheve Bulqizë, Devoll, Has, Kavajë, Kukës, Laç, Malësi e Madhe, Mat, Mirditë e Pukë, 6 punonjës pakësohen nga organika e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si dhe shtohen në organikë 57 punonjës.

Krijimi i degëve të kontrollit e të kalibrimit të mjeteve matëse në rrethe dhe emërimi i punonjësve të Drejtorisë Kombëtare të Metrologjisë dhe të Kalibrimit në qendër e në rrethe bëhet nga drejtori i kësaj drejtorie.

5. Drejtoria Kombëtare e Metrologjisë dhe e Kalibrimit, për efekt të pagave të punonjësve, të barazohet me drejtoritë e përgjithshme. Pagat e punonjësve të jenë sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.393, datë 3.9.1992, lidhja II-5 "Pagat mujore dhe renditja e detyrave sipas klasave për punonjësit e ministrave dhe institucioneve të tjera qendrore".

Paga e kryetarit dhe e punonjësve të degëve të kontrollit e të kalibrimit të mjeteve matëse në rrethe barazohet përkatësisht me pagën e shefit e të punonjësve të seksioneve në këshillat e rretheve dhe Bashkisë së Tiranës.

6. Drejtoria Kombëtare e Metrologjisë dhe e Kalibrimit të financohet nga Buxheti i Shtetit për vitin 1993. Shpenzimet buxhetore të jenë 10.3 milionë lekë, nga të cilët shpenzimet për aparatin administrativ 8.8 milionë lekë dhe investimet 1.5 milionë lekë.

Këto shpenzime të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave në Buxhetin e Shtetit për vitin 1993.

7. Drejtorisë Kombëtare të Metrologjisë dhe të Kalibrimit i lihen në dispozicion 100 për qind e të ardhurave që realizon nga shërbimet që kryhen. Të ardhurat të përdoren për investime, përmirësimin e kushteve të punës e të laboratorëve, përsosjen e bazës së saj etalonuese, shpërblimin e punonjësve dhe për nevoja të tjera të drejtorisë.

8. Drejtoria Kombëtare e Metrologjisë dhe e Kalibrimit organizon kurse kualifikimi për punonjësit e saj dhe për specialistë të tjerë. Pas kurseve të kualifikimit jepet dëshmia përkatëse.

Punonjësit e kontrollit e të kalibrimit të mjeteve matëse të rretheve dhe specialistët e laboratorëve të akredituar nga kjo drejtori, pajisen me lejet përkatëse të ushtrimit të detyrës.

Nuk lejohet ushtrimi i detyrës pa lejen përkatëse të lëshuar nga kjo drejtori.

9. Mjediset e zyrave dhe të laboratorëve, pajisjet, aparaturat, inventari fizik e ekonomik i sektorit të kontrollit të mjeteve matëse në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë, si dhe ai i inspektorëve të kontrollit të mjeteve matëse në këshillat e rretheve, i kalojnë Drejtorisë Kombëtare të Metrologjisë dhe të Kalibrimit. Të ardhurat e krijuara nga inspektorët e kontrollit të mjeteve matëse në këshillat e rretheve me llogari më vete dhe të ardhurat e krijuara që nga 1 janari i vitit 1993 nga

inspektorët e kontrollit të mjeteve matëse me llogari të përbashkët me këshillin e rrethit, kalojnë në të ardhurat e Drejtorisë Kombëtare të Metrologjisë dhe të Kalibrimit.

10. Drejtoria Kombëtare e Metrologjisë dhe e Kalibrimit krijon këshillin e saj prej 11 anëtarësh, në përbërje të të cilit ka edhe anëtarë të jashtëm. Anëtarët e këshillit të metrologjisë miratohen nga drejtori i kësaj drejtorie. Masa e shpërblimit për anëtarët e këshillit, kur janë të jashtëm, të jetë 300 lekë në muaj.

Këshilli i metrologjisë është organ këshillimor që jep mendime për problemet më themelore të metrologjisë dhe këshilla në fushën teknike e shkencore për drejtimet e zhvillimit të saj. Ai funksionon sipas rregullores së miratuar nga drejtori i Drejtorisë Kombëtare të Metrologjisë dhe të Kalibrimit.

11. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.43, datë 24.2.1984 dhe aktet e tjera nënligjore që bien në kundërshtim me këtë vendim shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi